

Prishtinë, 25 Shtator 2023

Ztr. Mentor ALISHANI,  
Rektor i Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti"  
Prishtina, Kosovo

*Ref.: Bashkëpunimi mes Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" dhe UN-Habitat.*

I nderuar ztr. Alishani,

Së pari, dëshirojmë të ritheksojmë falënderimet tona të sinqerta për mbështetjen tuaj ndaj Studimit të Fizibilitetit dhe Planit të Menaxhimit për fshatin Zym i Hasit në Prizren, të zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore. Studimi i Fizibilitetit dhe Plani i Menaxhimit për fshatin Zym i Hasit do të zhvillohet përmes një procesi ndër-institucional dhe të gjithëpërfshirë, me pjesëmarrjen e institucioneve qendrore dhe lokale, përfshirë Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komunën e Prizrenit, Këshillin e Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përfaqësues të fshatit Zym (mandatuar sipas ligjit për fshatin Zym), përfaqësues të akademisë dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Ky do të jetë grupi punues kryesor, dhe në bashkëpunim dhe takime me banorët e fshatit Zym, ata do të jenë përgjegjës për hartimin e planit të menaxhimit për fshatin Zym, me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore, promovimit të vlerave kulturore me rëndësi lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe zhvillimit të qëndrueshëm të tij.

Në një frymë të besimit dhe bashkëpunimit reciprok, me kënaqësi propozojmë kushtet dhe përgjegjësitë e mëposhtme për të drejtuar përpjekjet tona të përbashkëta, në mënyrë specifike mes UN-Habitat dhe Universitetit të Prizrenit, veçanërisht në kontributin profesional dhe shkencor nga stafi akademik i universitetit, me fokus në zhvillimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të menaxhimit për fshatin Zym i Hasit, Prizren. Ky bashkëpunim i përbashkët në zbatimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të menaxhimit për fshatin Zym i Hasit, do të përfshijë ndihmën në zhvillimin dhe organizimin e punëtorive, identifikimin e aseteve dhe sfidave të zonës, vlerësimin e gjendjes aktuale të zonës, sigurimin e komenteve në lidhje me drejtimit e zhvillimit hapësinor dhe socio-ekonomik të zonës, pjesëmarrjen në takime të lidhura me komunitetet dhe pjesëmarrjen në ekspozitat e hapura të rezultateve të punëtorive.

Përgjegjësitë specifike të UN-Habitat, përmes Programit për Zhvillimi Gjithëpërfshirës janë si vijon:

- Në koordinim me anëtarët, përcakton programin e takimeve të grupit punues;
- Në koordinim me anëtarët, përcakton planin dinamik të punës së grupit punues;
- Përpilon materialet përmbajtësore, dokumentet dhe prezantimet për takimet e grupit punues;
- Mbledh materialet përmbajtësore, dokumentet e hartuara, dhe i ndan me anëtarët e grupit punues;
- Përpilon strukturën e studimit të fizibilitetit dhe planit të menaxhimit;
- Përpilon mjetet hulumtuese dhe metodologjinë;
- Në koordinim me anëtarët përpilon draft-dokumentet e studimit të fizibilitetit dhe planit të menaxhimit;
- Në koordinim me anëtarët udhëheq takimet/ punëtoritë/ diskutimet publike;
- Komunikon me anëtarët e grupit punues rreth përcaktimit të takimeve e aktiviteteve të tjera.

Përgjegjësitë specifike të Universitetit të Prizrenit janë si vijon:

- Ofrojnë ekspertizë profesionale për plotësimin e detyrave të Grupit Punues, për fushën përkatëse të ekspertizës që e mbulon;
- Marrin pjesë në çdo takim të Grupit Punues;
- Ofrojnë mbështetje profesionale dhe teknike për realizimin e aktiviteteve të Grupit Punues, duke përfshirë:
- Shqyrtimin e dokumenteve përmbajtësore dhe legjisacionit në fuqi;
- Ofrimin e mbështetjes në hartimin e mjeteve hulumtuese;
- Ofrimin e ekspertizës profesionale në hartimin e studimit të fizibilitetit për fshatin Zym të Hasit në Prizren;
- Ofrimin e ekspertizës profesionale në hartimin e planit të menaxhimit për fshatin Zym të Hasit në Prizren.

Është përgjegjësia jonë e përbashkët të zhvillojmë konsulta të rregullta dhe të ngushta për të monitoruar dhe vlerësuar aktivisht përparimin e çdo projekti të përbashkët që mund të bashkë-dakordohet, si dhe për të shkëmbyer të gjitha informacionet dhe dokumentet e rëndësishme, duke përfshirë hulumtimet, raportet dhe çdo material tjetër relevant për aktivitetet, rezultatet dhe ndikimin përfundimtar të përpjekjeve tona të bashkëpunimit.

Kjo përgjegjësi për bashkëpunim do të mbetet në fuqi deri më 31 dhjetor 2024. Në dritë të aktiviteteve të vazhdueshme të programit në mbështetje të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe fshatit Zym, kërkojmë me mirësi miratimin tuaj të kësaj letre për të treguar aprovimin tuaj për përmbajtjen dhe pajtueshmërinë me kushtet e bashkëpunimit tonë.

Kjo Letër do të dorëzohet në dy kopje. Do të vlerësonim shumë nëse do të mund të pranoni kushtet e propozuara të bashkëpunimit të kësaj Marreveshjeje duke nënshkruar dy Letrat dhe duke kthyer një origjinal në zyrën tonë në Prishtinë.

Esteban Leon  
Shef i zyrës, a.i.  
UN-Habitat Kosovo

Konfirmoj dhe pajtohem: .....,

Data: .....

Mentor Alishani, Rektor

Universiteti i Prizrenit, Ukshin Hoti